



## BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

### Rezultatet nga Konferenca Rajonale

# Biznesi për Mirëqënien e Komunitetit

*Ekonomia Sociale për një rritje të qëndrueshme dhe  
gjithëpërfshirëse në Europën Juglindore*

**8 Dhjetor 2015 - Beograd**

Qëllimi i konferencës ishte ndarja e rezultateve dhe rekomandimeve të [Studimit Strategjik mbi Zhvillimin e Ekonomisë Sociale në Kontekstin e Strategjisë së Europës Juglindore 2014-2020](#) e zhvilluar nga Lëvizja Europiane në Serbi dhe SeCons- Development Initiative Group në 2014 dhe i përditësuar në 2015. Konferenca u organizua nga Lëvizja Europiane në Serbi me mbështetjen e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe në bashkëpunim me Impact Hub Beograd, fondacionin Heinrich Boll, Erste Bank, Njësinë e Reduktimit të Varfërisë dhe Përfshirjes Sociale të Qeverisë së Serbisë dhe Euricse.

Studimi jep një pamje të gjerë të situatës në sektorin e ekonomisë sociale në kuadër të **Strategjisë 2020 të Europës Juglindore** nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal. Qëllimi ishte ndarja e gjetjeve në një debat publik, i cili përfshinte të gjithë aktorët e rëndësishëm; përballja e eksperiencave të ndryshme si nga rajoni ashtu dhe nga vendet e tjera evropiane; krijimi i një plani veprimi për implementimin e strategjisë, vendosja e një dialogu të vazhdueshëm dhe shkëmbimi i eksperiencave mes aktorëve përkatës.

Mbi 100 pjesëmarrës morën pjesë në diskutimin dhe debatin e drejtuar nga folësit:

Ekspertë rajonale dhe autorë të studimit, ekspertë ndërkombëtarë, studiues, sipërmarrës nga **Belgjika, Britania e Madhe, Holanda, Italia, Greqia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria, Serbia dhe Kosova\***. Organizatorët dëshirojnë të falenderojnë të gjithë pjesëmarrësit, partnerët dhe folësit për kontributin e tyre të çmuar dhe përfshirjen aktive në konferencë. Rezultati është ky dokument, një produkt i njohurive të përmbledhura nga ekspertë, dhe jemi të sigurt që kjo do të bëjë diferencën dhe do të avancojë diskutimin dhe zhvillimin e ekonomisë sociale dhe sipërmarrjes sociale në Evropën Juglindore.



# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

Koncepti i ekonomisë sociale dhe sipërmarrjes sociale akoma nuk kuptohen apo njihen gjerësisht, qoftë nga publiku i përgjithshëm por dhe nga aktorët kyç në vendet e rajonit të Europës Juglindore.

Për të kuptuar natyrën dhe potencialin e ekonomisë sociale dhe ndërmarrjeve sociale dhe për të ndjekur një strategji për zhvillimin e mëtejshëm të tyre, do të ishte shumë e rëndësishme, edhe pse e vështirë, për të kapërcyer **konfuzionin konceptual** rreth këtyre koncepteve që është i zakonshëm jo vetëm në Europën Juglindore por dhe gjerësisht i përhapur në Europë. Përcaktimi i mëposhtëm dhe terminologjia derivon nga *Ekonomia Sociale dhe Sipërmarrja Sociale – Guida e Evropës Sociale*, Volumi 4, e redaktuar nga Komisioni European, e cila u përdor si një nga kornizat konceptuale bazë nga autorët e studimit strategjik:

**Ekonomia sociale:** një varietet organizimesh private që ndryshojnë si nga korporatat private ashtu edhe nga institucionet publike, dhe zakonisht ndjekin qëllimet e tjera më tepër sesa fitimin. Qëllimi i tyre kryesor është të sigurojnë mallra dhe shërbime për anëtarët e tyre apo për komunitetin në përgjithësi. Këto organizime kanë qenë aktive në Europë për gati dy shekuj dhe kanë qenë të njohura dhe të rregulluara në shumë vende përmes formave ligjore të veçanta (kooperativa, shoqëri të bashkëpunimit reciprok, shoqata, fondacione, organizata bamirëse etj) .

**Sipërmarrja sociale:** i referohet tendencës së gjerë nga ana e aktorëve të ndryshëm për të marrë përgjegjësinë e nevojave sociale si në sektorin publik, sektorin privat, shoqërinë civile apo organizime të ekonomisë sociale; organizime krejtësisht të reja janë formuar duke u inspiruar nga të njëjtat parime si organizimet e ekonomisë sociale, duke kombinuar dimensionet sociale me ato sipërmarrëse.

**Ndërmarrja sociale:** një tip i ri organizimi që ka lindur në fillim të viteve 1980; organizime private që ofrojnë të mira dhe shërbime në treg në një mënyrë sipërmarrëse inovative dhe i përdorin fitimet për të arritur objektivat sociale. Koncepti i ndërmarrjeve sociale përkon pjesërisht me organizimet tradicionale të ekonomisë sociale dhe përcaktohet nëpërmjet formave të ndryshme ligjore: Kooperativa, shoqëri të bashkëpunimit reciprok, shoqata, ndërmarrje private ose forma specifike të ngritura



vitet e fundit në kuadër të legjislacionit kombëtar.

Nevoja për një qasje rajonale për zhvillimin e ekonomisë sociale u shfaq pothuajse dy vjet më parë me [\*\*Deklaratën e Beogradit për Zhvillimin e Sipërmarrjes Sociale në Rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë\*\*](#), miratuar në mars 2014 dhe nënshkruar nga më shumë se 460 organizata nga gjithë rajoni. Krijimi i një strategjie të unifikuar u njoh si një hap i rëndësishëm në krijimin e një platforme rajonale për zhvillimin e ekonomisë sociale. Edhe pse kjo gjë ka i ka dhënë një shtysë të madhe forcimit të dialogut rajonal, ajo duhet të shoqërohet me angazhim të fortë dhe mbështetje financiare nga qeveritë në rajon.

"Studimi Strategjik mbi Zhvillimin e Ekonomisë Sociale në kontekstin e Europës Juglindore 2020" dhe "Konkluzionet dhe Rekomandimet për zhvillimin e Ekonomisë Sociale në rajonin e Europës Juglindore" gjithashtu morën në konsideratë deklaratën e lartpërmendur. Ky dokument integron konkluzionet dhe rekomandimet me rezultatet kryesore nga konferenca dhe mbështetet nga një **plan i detajuar zbatimi**.

## Kuadri Ligjor

Në përgjithësi, legjislacioni ekzistues mundëson krijimin ose zhvillimin e ekonomisë sociale dhe sipërmarrjes sociale përmes llojeve të ndryshme të formave ligjore - ku shoqatat dhe kooperativat janë opsionet më të zakonshme. Edhe pse këto korniza ligjore janë konsideruar gjerësisht si të paqëndrueshme dhe jo veçanërisht stimuluese, megjithatë, **ligjet ekzistuese mundësojnë ekonominë sociale dhe sipërmarrjen sociale përmes formave hibride dhe kombinimeve të organizatave jofitimprurëse me kompanitë tregtare**. Kooperativat janë ndoshta lloji i organizimit që vepron nën legjislacionin më të pafavorshëm, dhe mbeten më të lënë pas dore në shumicën e vendeve në rajon. Megjithatë, disa vende janë duke treguar shenjat e para të një gjallërimi të sektorit të kooperativave më në përputhje me tendencat e kohës. Në veçanti, kooperativat duhet të inkurajohen në fusha të tjera përveç bujqësisë.

Një mjedis mbështetës ligjor dhe institucional me siguri do të nxiste rritjen e këtij sektori. Megjithatë, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se duhet hartuar patjetër një



legjislacon i ri. Gjatë konferencës u shpreh në mënyrë të qartë, si një konsensus mes aktorëve, se miratimi i ligjeve të reja mund të çojë në rrezikun e mos marrjes në konsideratë të specifikave të këtij sektori ende në zhvillim dhe të brishtë. Sipas pjesëmarrësve, një qasje shumë më e mirë do të përfshinte zhvillimin e strategjive specifike me qëllim krijimin e një ekosistemi të favorshëm për sektorin:

- Legjislaconi duhet të sigurojë një të kuptuar të ekonomisë sociale dhe natyrës specifike e diversitetit të formave të saj organizative, krahas qëllimeve që i dallojnë ato nga shoqëritë tregtare. Theks i veçantë duhet të vihet në vlerën e shtuar që ata krijojnë në ndikimin e tyre social, ekonomik dhe mjedisor në komunitetet lokale. Çdo vend duhet të inkurajohet për të zhvilluar kuadrin e tij ligjor në përshtatje me nevojat specifike të sektorit dhe në përputhje me specifikat e vendit: politike, socio-ekonomike dhe kulturore. Në shumicën e rasteve, legjislaconi ekzistues mund t'i përshtatet formave të ndryshme të organizmave të ekonomisë sociale, dhe në mënyrë specifike sipërmarrjeve sociale. Për t'u bërë me të vërtetë mbështetës, legjislaconi duhet të mundësojë organizimet e ekonomisë sociale të kryejnë aktivitete sipërmarrëse në një shkallë më të gjerë;
- Përvoja nga vendet e tjera, ku ekonomia sociale është më e zhvilluar tregon se kooperativa është forma e preferuar ligjore dhe e organizimit për shkak se ajo është fleksibël, është e rrënjësuar në komunitetet lokale, plotësisht në përputhje me vlerat e ekonomisë sociale dhe është e njohur ligjërisht. Në shumicën e vendeve të Europës Juglindore, modeli i kooperativës u kompromentua gjatë komunizmit dhe legjislaconi ekzistues nuk favorizon zgjerimin e tij në fusha dhe sektorë të tjerë përveç bujqësisë. Krijimi i kooperativave të reja mund të stimulohet duke ndryshuar ligjet dhe duke trajtuar më në fund çështjen e aseteve të ngrira. Së bashku me stimuj të tjerë, kryesisht fiskalë, kjo mund të stimulojë shndërrimin e tyre në lojtarë modernë dhe efektivë të ekonomisë sociale në shumë sektorë;



- Kuadri ligjor ka nevojë më tepër të adresojë natyrën e organizimeve të ekonomisë sociale sesa të insistojë në forma specifike ligjore dhe organizimi. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se legjislacioni mbështetës për ekonominë sociale duhet të përfshijë rregulloret tatimore, ligjet e prokurimit publik dhe rregullore të punësimit për të lejuar një përfshirje më të madhe të organizimeve të ekonomisë sociale, si ofrues të rëndësishëm të mallrave dhe shërbimeve.

## Kuadri Institucional

Perceptimi mbizotërues i **kornizave aktuale institucionale është se ato janë të papërshtatshme dhe joefektive**. Boshllëku kryesor qëndron në mungesën totale të institucioneve apo të organeve specifike për koordinimin e sektorit të ekonomisë sociale në tërësi. Vetëm Kroacia ka themeluar Departamentin për Përgatitjen dhe Zbatimin e Projekteve në fushën e Sipërmarrjes Sociale (2015) dhe është ende e vështirë për të vlerësuar efektivitetin e kësaj zyre dhe kontributin e saj në zhvillimin e sipërmarrjes sociale. Qeveritë e tjera në rajon kanë krijuar institucione apo organe të ndryshme përgjegjëse për disa aspekte të ekonomisë sociale - kryesisht për shoqërinë civile apo sektorin jo-fitimprurës, punësimin, mirëqenien sociale, kooperativat apo sipërmarrjen. Analiza ka tërhequr gjithashtu vëmendjen për një mbiprodhim të dokumenteve strategjike në fusha të ndryshme, të cilat, përveçse të tepruara, shpesh mbivendosen ose konfliktojnë. Koordinimi i paqartë mes institucioneve dhe bashkëpunimet pa interes ose të papërshtatshme, si dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve në kuadër të sektorit të ekonomisë sociale kanë rezultuar në progres të ngadaltë në krijimin e një mjedisi mbështetës institucional. Një qasje e tillë e fragmentuar ndaj ekonomisë sociale mund vetëm të thellojë të kuptuarit mbizotërues, që nuk arrin të shohë ekonominë sociale si një sektor unik, pavarësisht natyrës së tij diverse, formave ligjore dhe fushave të aktivitetit.

Mungesa e ndërgjegjësimit mbi rolin e rëndësishëm të luajtur tashmë nga ekonomia sociale dhe rëndësia edhe më e madhe që ajo mund të ketë në zhvillimin social dhe rimëkëmbjen ekonomike ka rezultuar në një mungesë të angazhimit politik drejt krijimit



të një mjedisi stimulues. Perceptimi i përgjithshëm është se zhvillimi i ekonomisë sociale ka pak ose aspak mbështetje nga qeveritë dhe institucionet e tyre. Ndërsa përpjekjet për të krijuar një mjedis mbështetës ligjor dhe institucional për sipërmarrjen sociale janë të njohura dhe të mirëpritura, kërkohet një vullnet i fortë politik, bazuar në dhe i zhvilluar nga bashkëpunimi mes sektorëve dhe aktorëve të ndryshëm në këtë proces.

Kushtet që duhet të plotësohen me qëllim krijimin e një kuadri institucional adekuat që plotëson nevojat e aktorëve të ekonomisë sociale në çdo vend të Europës Juglindore përfshin:

- Një axhendë të politikave në fushën e ekonomisë sociale për të identifikuar objektiva specifike e konkrete, adoptimin e një qasje nga poshtë-lart që mobilizon të gjithë aktorët e ekonomisë sociale, por mbi të gjithë ata që e praktikojnë. Ekonomia sociale duhet të përfshihet në axhendën e politikave të qeverive si një nga prioritetet në zhvillimin socio-ekonomik. Adoptimi i një strategjie për ekonominë sociale duhet të jetë baza për zhvillimin e politikave koherente dhe masave mbështetëse, por më e rëndësishmja, këto masa duhet të shoqërohen me buxhete dhe angazhim të fortë për zbatimin e tyre;
- Një organizatë “ombrellë” private dhe e pavarur për të përfaqësuar organizatat ekzistuese si kanali kryesor i komunikimit mes vendimeve-marrësve dhe organizatave të ekonomisë sociale. Ky entitet duhet të angazhohet të advokojë dhe llojë në interes të organizatave të ekonomisë sociale dhe të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e këtij sektori për shoqërinë si një e tërë. Ky entitet do të ofronte një qasje të unifikuar dhe do të eliminonte fragmentimin dhe inefiçencën e shkaktuar nga shumë programe dhe aktivitete të pakoordinuara të institucioneve të ndryshme qeveritare. Ai duhet të shërbejë gjithashtu përveçse si qendër burimore në ofrimin e shërbimeve të ndryshme, ashtu edhe si një burim informacioni për aktorët e interesuar për t’u angazhuar në ekonominë sociale;



- Një institucion i vetëm qeveritar ombrellë ose një organizëm përgjegjës për kordinimin, promovimin dhe zhvillimin e sektorit të ekonomisë sociale si një e tërë rekomandohet fuqishëm. Ky institucion do të udhëheqë një qasje të re në zhvillimin e ekonomisë dhe sipërmarrjes sociale në një nivel institucional duke përqafuar dialogun me aktorë të tjerë dhe prezantimin e reformave proceduriale duke krijuar kështu një mjedis më të favorshëm për të bërë biznes në këtë sektor.

Kuadri institucional duhet të reflektojë një kuptim më të gjerë dhe njohje politike të ekonomisë sociale si një gjenerues i rëndësishëm i inovacionit social, prodhimit dhe shërbimeve në sektorë të ndryshëm ekonomikë, duke shmangur riskun e të konsideruarit thjesht një mjet për integrimin e grupeve vunerabël në punësim ose ofrimin e shërbimeve sociale çka është rasti më i shpeshtë sot.

## Incentivat Financiare

Aktualisht, pjesa më e madhe e incentivave të limituara financiare të disponueshme në ekonominë sociale sigurohen nëpërmjet skemave financuese për organizatat e shoqërisë civile ose përmes masave aktive të tregut të punës bazuar në fondet e Bashkimit Europian (BE) në veçanti programet e **Instrumentit për Asistencën e Para-aderimit** (IPA) dhe Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal (ERDF). Përveç kësaj, shumë burime financiare për zhvillimin e ekonomisë sociale vijnë nga donatorë ndërkombëtarë, kryesisht Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), Banka Botërore (BB), Këshilli Britanik, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe të tjerë.

**Mekanizmat financiarë të ofruara nga sektori financiar privat janë të rrallë, sporadikë dhe të pamjaftueshëm.** Shumë të munguar në sektorin financiar janë financimi fillestar, kapitali i start-upit, huatë, mikro-kreditë dhe mjete të tjera financiare të dizenuara për nevojat dhe specifikat e sektorit të ekonomisë sociale, i cili është shpesh i perceptuar nga institucionet financiare si me fitime të ulëta dhe risk të lartë.



Disa indikatorë konkretë në atë se si mund të krijohen incentiva financiare të favorshme për zhvillimin e ekonomisë sociale:

Aspekti më i rëndësishëm që ka nevojë të prioritetizohet është zhvillimi i kuadrit financiar mbështetës. Ai duhet të ofrojë mundësi të qëndrueshme financimi për organizatat e ekonomisë sociale dhe të zhvillojë incentiva publike sistematike, ashtu edhe mekanizma publike-private për zhvillimin e organizatave të reja të ekonomisë sociale. Kjo do të përfshijë grante start-upi dhe skema kredish të buta dhe do të ofrojë mekanizma financiare për të shkallëzuar aktivitetet ekonomike të organizatave të ekonomisë sociale;

- Në vijim, subvencione të tjera mbështetëse do të ofrohen si ulje apo përjashtime nga taksat për aktivitete dhe tipe specifike organizatash. Mbështetje e ndryshme duhet të ofrohet për organizata në stadi të ndryshme zhvillimi (start-upe, të zhvilluara dhe në rritje e sipër);
- Prokurimi publik duhet të përfshijë organizatat e ekonomisë sociale, jo vetëm ato të deklaruara, por dhe të pranojë qasjen e tyre të privilegjuar në kontratat publike për ofrimin e shërbimeve dhe mallrave në bazë të vlerës së shtuar që ato ofrojnë. Direktiva e re e BE-së për Prokurimin Publik<sup>1</sup> mund të shërbejë si një udhërrëfyes për harmonizimin e rregullave të prokurimit publik që t'u përshtaten më shumë parimeve të ekonomisë sociale;
- Qeveritë duhet të lehtësojnë aksesin në burimet financiare përmes zhvillimit të fondeve specifike për ekonominë sociale dhe duke mbështetur organizatat si banka etike, fonde investimi social, po aq sa iniciativa nga poshtë-lart si inkubatorët dhe crowd-funding (shuma të vogla kapitali të mbledhura nga individë të ndryshëm që financojnë një ndërmarrje të re).

## Krijimi i Kompetencave

**Vlerësimet ekzistuese të sektorit të ekonomisë sociale tregojnë nivele të ulëta të kompetencës në kapacitetin sipërmarrës, në veçanti aftësi**

<sup>1</sup> Directive 2014/24/EU of the European Parliament and of the Council of 26 February 2014 on public procurement and repealing Directive 2004/18/EC – view the EU Procurement Directive (public sector)





**menaxheriale dhe financiare.** Përveç kësaj, bashkëpunimi i dobët me sektorin e biznesit të zakonshëm (tradicional) pengon shkëmbimin e njohurive dhe aftësive dhe për më tepër, ndikon në pozicionimin e dobët në treg të produkteve dhe shërbimeve të ekonomisë sociale. Një mungesë e tillë e kompetencave specifike, së bashku me një mungesë të mbështetjes financiare, është përgjegjëse për luhatje të mëdha në sektor, dhe organizata të ekonomisë sociale të paqëndrueshme dhe jetë-shkurtra.

Shtytja më e rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë sociale vjen nga brenda sektorit: aktorë dhe aktivistë luajnë një rol themelor në promovimin e ekonomisë dhe sipërmarrjes sociale, duke ofruar mbështetje ndaj organizatave të sapo themeluara dhe duke krijuar rrjete nga poshtë-lart për transferimin e njohurive specifike.

Edhe pse mungesa e kulturës sipërmarrëse ngadalëson rritjen, ekziston një potencial i madh në kapitalin social - më e dukshme në kohën e fatkeqësive natyrore - i cili duhet të shfrytëzohet edhe për krijimin e zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik në komunitetet lokale. Vlera të tilla si solidariteti, bashkëpunimi dhe besimi kanë qenë gjithmonë parimet themelore të ekonomisë sociale. Ringjallja e këtyre vlerave do të japë një nxitje të madhe për të gjithë sektorin dhe anasjelltas: me zhvillimin e ekonomisë sociale, kapitali social rritet edhe më shumë. Ekonomia sociale, për këtë arsye, mund të luajë një rol të rëndësishëm si një nxitës e orientues i dialogut dhe bashkëpunimit rajonal.

Disa nga rekomandimet e dala që mund të kapërcejnë kufizimet e shkaktuara nga mungesa e kompetencave adekuate në këtë sektor:

- Zhvillimi/krijimi i rrjeteve ndërsektoriale ose mbështetja e qendrave si motorë për transferimin e njohurisë dhe teknologjisë, shkëmbimin e ideve dhe ndarjen e praktikave më të mira;
- Incentivat jofinanciare, mentorimi, shërbimet administrative dhe konsultuese të ofruara nga qeveria ose sektori i biznesit; bashkëpunimi ndërmjet kooperativave; programet e bashkëpunimit me realitetet ku ekonomia sociale është më e zhvilluar; pjesëmarrja në programet e BE-së për shkëmbim dhe bashkëpunim;



- Krijimi i programeve të edukimit formal dhe informal në bashkëpunim me sektorin akademik, duke përfshirë gjithashtu sipërmarrjen në kurrikulat e edukimit profesional dhe programet e ritrajnimit;
- Integrimi i njohurive specifike brenda sistemit të edukimit formal nënkupton ngritjen e gjeneratave të reja të sipërmarrësve socialë dhe individëve që do të krijojnë një ekonomi të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse;
- Zhvillimi i aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve përmes programeve të ndryshme të mentorimit; shkëmbimin me sektorin e biznesit, të metodave dhe teknikave të krijimit të aftësive, si dhe forcimin e bashkëpunimit me komunitetin e biznesit. Arsimi duhet të rrisë sensibilizimin e rëndësishëm të ekonomisë sociale dhe rolin e saj në krijimin e përfitimeve të përbashkëta; fokusi nuk duhet të jetë vetëm në kulturën sipërmarrëse por gjithashtu në krijimin e një “kulture sipërmarrëse sociale”.

## **Promovimi i konceptit të ekonomisë sociale**

Një përpjekje shtesë është e nevojshme në ngritjen e një ndërgjegjësimi më të gjerë, kryesisht në mes qeverisë dhe vendimmarrësve, se ekonomia sociale mund të luajë një rol të rëndësishëm në rimëkëmbjen ekonomike, duke vazhduar të bazohet në parimet e integruara të përgjegjësisë sociale dhe mjedisore. Përveç kësaj, publiku i gjerë duhet ta perceptojë këtë sektor jo vetëm si një sektor që ofron shërbime sociale dhe që punëson grupet e marxhinalizuara, por edhe si një gjenerues i rëndësishëm i inovacionit social dhe një mjet progresiv i ripërdorimit të burimeve lokale për të adresuar nevojat sociale në mënyrë të qëndrueshme dhe për rritjen e punësimit. Një qëllim i tillë është sfidues edhe atëherë kur ekonomia sociale dhe ndërmarrjet sociale kanë një traditë shumë më të gjatë, ku komuniteti është më koheziv, numri i organizatave është më i lartë dhe kontributi në ekonomi është më i rëndësishëm. Në Evropën Juglindore, situata është edhe më e komplikuar për shkak të disa pengesave të veçanta, kryesisht të lidhura me trashëgiminë komuniste, mosbesimin, mungesën e kuptimit të konceptit të ekonomisë sociale, mungesa e kuadrit të duhur ligjor dhe institucional dhe organizata “ombrellë” joefektive nëse ekziston ndonjë.



Sugjerimet e mëposhtme dolën nga pjesmarrësit, mbi mënyrës sesi të përmirësohet sensibilizimi në mes politikëbërësve, praktikuesve dhe publikut të gjerë:

- Identifikimi dhe përcaktimi i interesit dhe qëllimeve të përbashkëta mes aktorëve kryesorë të ekonomisë sociale dhe themelimi i një organizate “ombrellë”;
- Krijimi i një strategjie për të promovuar një kuptim të ekonomisë sociale, identifikimi i aktorëve dhe targetimi e adaptimi i mesazheve në mënyrë të përshtatur-qeveria, media, sektori i biznesit dhe akademisë:
  - Komunikime të rregullta me anëtarët e qeverisë dhe institucioneve, dhe advokim për çështje të ekonomisë sociale;
  - Një strategji mediatike e rregullt dhe e përshtatshme (përmbledhje periodike, seminare për gazetarët, çmime për reportazhin më të mirë në çështjet e ekonomisë sociale etj);
  - Partnership me institucionet arsimore (dizenjimi i programeve edukese, kurrikulave, inkubatorët);
- Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit (inkurajimi i përfshirjes së organizatave të ekonomisë sociale në zinxhirin e furnizimit, zhvillimi i fondacioneve korporative për ekonominë sociale, inkurajimi i filantropisë dhe përgjegjshmërisë sociale të biznesit (CSR), inkurajimi i projekteve të përbashkëta për zhvillimin e komunitetit etj);
- Promovimi i praktikave më të mira (psh. përmes përmbytjes online si website, blogje, media sociale, materiale video, krijimi i çmimeve për ndërmarrjen sociale apo organizatën e ekonomisë sociale më të mirë etj.);
- Prezantimi i një emërtimi universal në nivel rajonal (psh. Çertifikata e cilësisë së ekonomisë sociale);

## Kërkimi dhe monitorimi

Një axhendë kërkimi duhet të hartohet për këtë sector, sëbashku me një regjistër gjithëpërfshirës të organizatave të ekonomisë sociale dhe një qasje metodologjike për



mbledhjen e të dhënave. Një grup i unifikuar i treguesve për matjen e performancave të ndërmarrjeve sociale është me rëndësi të madhe për krijimin e një baze të dhënash të përshtatshme për studime krahasuese. Kjo do të mundësonte monitorimin sistematik dhe analizën e sektorit të ekonomisë sociale, do të ofronte informacion të saktë mbi madhësinë dhe strukturën e sektorit dhe do të lehtësonte shumë të kuptuarit e ndikimit dhe efikasitetit të saj. Kërkime dinamike në këtë fushë do të ofronin të dhëna të duhura në kohë që mund të ndihmojnë në formimin e sektorit, të kontribuojnë për të gjeneruar masa të reja mbështetëse, dhe të lejojnë rritjen e tij. Për më tepër, do të gjeneronte breza të rinj studiuesish që do të përfshiheshin në rrjetet kërkimore në nivel evropian, duke transferuar arritjet e avancuara dhe përvojat nga kontekstet lokale.

## **Rekomandime për forcimin e dialogut dhe bashkëpunimit rajonal në ekonominë sociale**

Rekomandimet kyçe për inkurajimin e iniciativave rajonale përfshijnë:

### **1. Krijimin e një “infrastruktura” rajonale që do të bënte të mundur dhe lehtësonte komunikimin dhe bashkëpunimin duke përfshirë:**

- Një organizatë rajonale “ombrellë” e themeluar si një mekanizëm koordinues dhe organizëm advokues, me qëllim promovimin e ekonomisë sociale në rajon dhe advokimin për adoptimin e masave strategjike dhe kuadrin rregullator brenda kontekstit kombëtar;
- Një portal webi i dizenuar për të qenë një platformë mediatike që ofron informacion tek organizatat e ekonomisë sociale, aktivitetet, skemat financuese, mbështetjen e disponueshme financiare dhe jofinanciare, praktikat më të mira, kërkesa për partneritet etj;
- Një regjistër ose bazë të dhënash, e cila ofron informacion mbi organizatat e ekonomisë sociale në rajon dhe për pasojë vendosjen e një marke rajonale “Ekonomia Sociale – ES”.



## 2. Përmirësimin e transferimit të njohurive përmes:

- Mekanizmave të rregullt për transferimin e njohurive rajonale të tilla si rrjetëzime, vizita, çmime, konferenca, internshipe dhe praktika të tjera që mund të kontribuojnë në shkëmbimin e njohurive dhe përvojave specifike në krijimin dhe menaxhimin e projekteve dhe organizatave të ekonomisë sociale;
- Eventeve rajonale ndërsektoriale me përfshirjen e aktorëve kryesorë nga qeveria, sektori privat, jofitimprurës dhe sektori akademik me qëllim transferimin e njohurive dhe përmirësimin e kapaciteteve të organizatave të ekonomisë sociale;
- Promovimit të praktikave më të mira të iniciativave dhe bashkëpunimeve përtej kufijve dhe ndarja e modeleve efektive ekzistuese të partnershipeve;
- Promovimit të shërbimeve inovative, mekanizmave, metodologjive, formave organizative etj. me një vështrim në aplikimin rajonal potencial të ekonomisë sociale;
- Një rrjet për kërkime krahasuese në rajon.

## 3. Mekanizma mbështetës për iniciativat rajonale ku përfshihet:

- Një fond rajonal për mbështetjen e projekteve të bashkëpunimit rajonal mes organizatave të ekonomisë sociale ose bashkëpunimeve ndërsektoriale që promovojnë ekonominë sociale. Fondi mund të sigurojë gjithashtu mbështetje ose garanci në përdorimin e fondeve të BEsë;
- Inkurajimi i sektorit bankar dhe atij financiar privat, dhe mbështetje e mëtejshme për iniciativat që vijnë nga ky sektor (si fondacioni Erste, Unicredit etj) për të zhvilluar mekanizma financiarë në mbështetje të projekteve dhe iniciativave rajonale të ekonomisë sociale.



# Plani i Zbatimit

## 1. Kuadri Ligjor dhe Institucional

### 1.1. Si të influencohet axhenda politike

Qëllimet	Veprimet	Zbatuesi i aktivitetit	Burimet	Mjetet e verifikimit	Grafiku kohor
Identifikimi i prioriteteve të realizueshme	Organizimi i konsultimeve nga poshtë-lart	Grup pune për ekonominë sociale (i përbërë nga aktorë të ndryshëm), Organizata Ombrellë	Shteti/ BE/ donatorë bilateralë	Ndërtimi i grupit të punës; Themelimi i organizatës ombrellë; Lista e prioriteteve	2016
Gjenerimi i vullnetit politik dhe mbështetjes	Puna me politikanë dhe anëtarë të parlamentit, duke i ftuar ata në evente; duke ndarë lajme nga burime rajonale, kombëtare dhe nga BE; përfshirja në konsultime.			Numri i vendim-marrësve së dhe/ose përfaqësuesve të institucioneve në evente të ekonomisë sociale; Numri i organizatave të ekonomisë sociale që marrin pjesë në procesin politik	2016
Influencimi i vendimmarrjes në politikat lokale	Identifikimi dhe puna me kryetarët; aktivitete promovuese dhe sesione informimi, përfshirje të medias.			Numri i autoriteteve lokale të përfshira; Numri i eventeve lokale për promovimin e NS; Numri i mediave të përfshira, raporteve mediatike nga eventet e zhvilluara	2016



# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart, Sustainable and Inclusive Growth of the South East Europe

## 1.2. Roli i institucioneve kombëtare

Qëllimet	Veprimet	Zbatuesi i aktivitetit	Burimet	Mjetet e verifikimit	Grafiku kohor
Krijimi i mjedisit mundësues për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale (kuadri legjislativ dhe institucional në mbështetje dhe promovim të ndërmarrjeve sociale)	Përcaktimi i ndërmarrjeve sociale në nivel kombëtar; Krijimi i regjistrit të ndërmarrjeve sociale; Dizenjimi i instrumentave financiarë; Thjeshtësimi i procedurave administrative për ndërmarrjet sociale; Reduktimi i taksave;	Institucioni kombëtar në kooperim me grupin e punës në ekonominë sociale	Shteti/ BE/ donatorë bilateral	Ekzistenca e përkufizimit të NSve; Ekzistenca e qendrës së referimit; Ekzistenca e regjistrit të NSve; Numri i instrumenteve financiare për NSTë; Ndërtimi i “one-stop shops” për organizatat e ekonomisë sociale; Numri i përfitimeve nga taksat ose incentivat për NSTë.	Nga 2016 në vazhdim
Krijimi i linjës së buxhetimit të dedikuar për ndërmarrjet sociale.	Ofrimi i evidences për krijimin e fondit (impakti ekonomik dhe social i NSve, burime në dispozicion për krijimin e fondit, rregulla të përdorimit të burimeve etj.)	Institucioni kombëtar në kooperim me grupin e punës në ekonominë sociale		Numri i linjave të buxhetit të krijuara për NSTë dhe aspekte të tjera të tyre	2017



# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

## 1.3. Çfarë na nevojitet nga një organizatë ombrellë?

Qëllimet	Veprimet	Zbatuesi i aktivitetit	Burimet	Mjetet e verifikimit	Grafiku kohor
<b>Promovimi i Ndërmarrjeve Sociale (NS)</b>					
Rritja e vizibilitetit të NSve	Krijimi i identitetit të tyre, Organizimi i fushatave promicionale, Ngritja e një portali online (platforme web) për NSTë.	Organizatë Ombrellë	Sektori privat/shteti/BE/Fonde rajonale	Numri i fushatave promicionale; Numri i artikujve për NSTë dhe organizatën ombrellë në media; Numri i vizitave në portal/façe	2016/2017 – në vazhdim
Advokimi për një mjedis më mbështetës për NSTë	Propozimi i kuadrit politik, financiar, ligjor, institucional; Hulumtim në fushën e NS-ve			Numri i sugjerimeve (ligjore, financiare...); Numri i studimeve shkencore, artikujve të publikuar	2016 – në vazhdim
Nxitja e rritjes së sipërmarrjes sociale	Mbështetja e bashkëpunimit mes sipërmarrjeve dhe institucioneve të edukimit; sensibilizimi i sektorit të biznesit; bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar;			Numri dhe llojet e bashkëpunimeve të krijuara	2017 – në vazhdim
<b>Mbështetja e NSve</b>					
Nxitja e shkëmbimit të informacionit	Krijimi i platformës web; ofrimi i informacionit; organizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit; evente rajonale dhe kombëtare			Faqet e webit ekzistuese; Numri i fushatave; Numri i konsultimeve; Numri i eventeve	2017
Nxitja e ndarjes së njohurive	Përmes platformës së webit dhe mbledhjes së të dhënave; trajnime rajonale dhe kombëtare; evente publike			Numri i artikujve, postimeve, deklaratave për shtyp; Numri i vizitave të faqes;	2017



European Movement  
Serbia



IMPACT HUB  
Belgrade  
Belgrade, Serbia



ERSTE  
Bank



SOCIAL INCLUSION AND  
POVERTY REDUCTION  
UNIT



HEINRICH BOELL STIFTUNG  
SERBIA, MONTENEGRO, KOSOVO



Euricse



Bioidea



Regional Cooperation Council

SEE2020

2014-2020





# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

				Numri i trajnimeve dhe eventeve	
Ofrimi i shërbimeve ndaj NSve (kontabiliteti, juridike, marketing, edukimi dhe trajnimi etj)	Rekrutimi i ekspertëve që mund të ofrojnë këto shërbime; Zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve specifike ndaj aktorëve të NSve			Numri i ekspertëve të rekrutuar; Numri i shërbimeve të ofruara; Numri i klientëve/përdoruesve	2018 - në vazhdim
Asistimi i aktorëve të NSve në rritjen e ndërmarrjes së tyre	Krijimi i një regjistri të NSve, dizenjimi i metodologjisë për rritjen			Regjistri i krijuar Metodologji e zhvilluar	2018 – në vazhdim
Ngritja e fondeve	Krijimi i ekipeve të menaxhimit të projekteve dhe ngritjes së fondeve			Ekipi i krijuar për menaxhimin dhe ngritjen e fondeve; Numri i fondeve të ngritura; Shuma e fondeve të ngritura;	2016
Ndërtimi i partnershipeve	Krijimi i regjistrimit për aktorët e interesuar; Lobim për partnership dhe projekte të përbashkëta			Regjistri i krijuar; Numri i partnerëve; Numri i projekteve në partneritet	2016



# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

## 2. Mbështetje financiare dhe jofinanciare ndaj NSve

### 2.1. Për çfarë lloji mbështetjeje financiare kanë nevojë ndërmarrjet sociale?

Qëllimet	Veprimet	Zbatuesi i aktivitetit	Burimet	Mjetet e verifikimit	Grafiku kohor
<b>Niveli Start-up</b>					2016 – në vazhdim
Lehtësira tatimore; fonde pensioni/sociale; TVSH; tatimi mbi të ardhurat	Advokimi për përmirësime në rregulloret e taksave	Investitorë / aktorë privatë, institucione shtetërore, institucione lokale	Sektori privat/shteti/BE/ Fonde rajonale/ donator bilateralë	Numri i incentivave dhe përfitimeve nga taksat	
Skema të disponueshme për start-upet, si publike ashtu edhe nga donatorë	Advokimi për krijimin e fondeve publike (p.sh. fondi i solidaritetit) dhe fondet e kapitalit të ndërmarrjeve			Numri i fondeve në dispozicion Numri i skemave të fondeve në dispozicion	
Mikro kredi të disponueshme	Lobim për ligjin mbi mikro-kreditë Promovimi i mikro-kreditimit			Ligji Ekzistues  Numri i mikro-kredive të marra	
Fondet nga shumë individë (Crowd-funding) në dispozicion	Advokimi për skema financimi rajonale			Numri i fushatave të crowdfunding Numri i fushatave të suksesshme crowdfunding Shuma e burimeve të ngritura	



# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

Kapitali i diversifikuar i start-up në dispozicion	Promovimi i krijimit të “bankave etike”, фондеве të kthyeshme, përdorimi i kapitalit të biznesit, subvencioneve të punësimit, advokimi për vendosjen e фондеве të kthyeshme			Numri i фондеве start-up; Numri i instrumenteve financiare të tjera për NSTë; Shuma e burimeve në dispozicion; Shuma e burimeve të fituara; Numri i projekteve të NSve të financuara;
<b>Niveli i Zhvillimit</b>				
Prokurimi Publik (PP) i aksesueshëm për NSTë	Advokimi për reformën e procedurave të prokurimit publik		Sektori privat/ Shteti/ BE/ фонде rajonale/ donatorë bilateralë	Numri i kontratave të PP me NSTë (dhe përqindja) Shuma e burimeve të fituara përmes kontratave të PP
Filantropia e sipërmarrjeve	Advokimi për përfshirje më të madhe të sektorit privat në filantropi			Numri i fondacioneve të korporatave Numri i donacioneve nëpërmjet përgjegjshmërisë sociale të biznesit (CSR) Numri i thirrjeve për projekt-propozime Shuma e burimeve në dispozicion dhe të fituara



# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

<b>Rritja</b>				
Skemat e aksesueshme të kredisë	Hartimi i propozimeve për skema të favorshme për NSTë		Sektori privat/ Shteti/ BE/ fonde rajonale/ donatorë bilateralë	Numri i skemave të kredive për NSTë Shuma e burimeve të fituara
Fondet e investimit të BE në dispozicion	Advokimi te politikanët dhe anëtarët e parlamentit për të njohur rëndësinë e të pasurit të këtyre fondeve			Numri i fondeve në dispozicion Shuma e burimeve në dispozicion dhe të fituara
Investitorët ndikues të përfshirë në çështjen e NSve	Ngritja e regjistrimit të të gjithë aktorëve të interesit dhe caktimi i roleve potenciale Advokimi për një përfshirje më të gjerë të investitorëve ndikues në NS			Regjistri i krijuar Numri i investitorëve Shuma e burimeve në dispozicion dhe të fituara

## 2.2. Për çfarë lloji mbështetjeje jofinanciare kanë nevojë ndërmarrjet sociale?

Qëllimet	Veprimet	Zbatuesi i aktivitetit	Burimet	Mjetet e verifikimit	Grafiku kohor
Krijimi i njohurive	Trajnime, workshope, leksione	Aktorë private të interesuar (institucione edukimi, dhoma tregtie, agjenci zhvillimi rajonale, entitete zhvillimi ndërkombëtare,	Ndërmarrjet sociale, inkubatorët, institucionet dhe organizatat arsimore Sektori privat/ Shteti/BE/ donatorët bilateralë	Numri i trajnimeve, leksioneve; Numri i pjesmarrësve	2016 – në vazhdim



# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

Krijimi i aftësive- menaxhimi	Programe mentorimi	institucionet e BE	Numri i programeve të mentorimit; Numri i pjesmarrësve
Krijimi i aftësive - marketing dhe shitje	Vizita studimore dhe praktika stazhi		Numri i vizitave studimore; Numri i pjesmarrësve Numri i organizatave/vendeve të përfshira
Krijimi i aftësive-punonjës produktivë	Vullnetarizmi (marketing dhe produkt)		Numri i vullnetarëve; Numri i orëve të punës vullnetare
Krijimi i ndërgjegjësimit	Trajnimi në punë		Numri i programeve të trajnimit në punë
<b>Burime teknike</b>	Krijimi i inkubatorëve të bizneseve socialë- mbështetje eksperte		Numri i inkubatorëve; Numri i projekteve të NSve; Numri i ekspertëve në mbështetje të NSve
Hapësira e punës			Numri dhe madhësia e hapësirave të punës
Pajisje			Numri dhe lloji i pajisjeve
Materiale për prodhim			Lloji dhe shuma e materialeve



# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

## 3. Zhvillimi i kompetencave për NSTë

3.1 Çfarë lloji aftësish dhe njohurish kanë nevojë NSTë e Europës juglindore?

Qëllimet	Veprimet	Zbatuesi i aktivitetit	Burimet	Mjetet e verifikimit	Grafiku kohor
<b>Komunitet qytetarësh aktivë dhe të përgjegjshëm nga ana sociale</b>	<b>Mësimi i NSve dhe aktorëve të tjerë sesi të investojnë, si të udhëheqin dhe si të mobilizojnë komunitetin</b>	Organizata Ombrellë	Sektori privat/ Shteti/BE/ fondet rajonale		
Aftësitë komunikuese të fituara (veçanërisht në shitjet e marketing)	Krijimi i qendrave burimore që ofrojnë: trajnime, konsultime, mentorim, ngritje fondesh, franshiza, vizita studimore, shkëmbim punonjësish/vullnetarësh , rrjetëzim			Numri i qendrave burimore të krijuara Numri i trajnimeve; Numri i konsultimeve; Numri i pjesmarrësve; Numri i vizitave studimore dhe numri i pjesmarrësve	2016
Aftësitë menaxheriale të adoptuara				Numri i projekteve të implementuara; Prodhimi i rritur i të mirave dhe shërbimeve	2016
Aftësi në ngritjen e fondeve të adoptuara					2016



# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

## 3.2 Si të krijohet një qasje hulumtuese koherente për NSTë në Europën Juglindore (EJL)?

Qëllimet	Veprimet	Zbatuesi i aktivitetit	Burimet	Mjetet e verifikimit	Grafiku kohor
<p>Krijimi i indikatorëve për NSTë; zhvillimi i një metodologjie të unifikuar; krijimi i një rrjeti kërkimi rajonal që përfshin zyrat kombëtare të statistikave</p> <p>Eksplorimi i shembujve të mirë të ndërmarrjeve sociale, OJFve dhe grupeve të qytetarëve dhe cilat janë qëllimet e tyre kryesore</p> <p>Krahasimi i ndërmarrjeve sociale në EJL me shembuj globalë, rajonalë dhe evropianë (kontakte kulturore)</p> <p>Fondet financiare, kriteret e donatorëve dhe kushtet për mbështetjen e projekteve të sipërmarrjeve sociale</p> <p>Krijimi i fondit kërkimor rajonal</p>	<p>Studimi dhe kërkimi; Analiza e të dhënave aktuale statistikore mbi organizatat e ekonomisë sociale; Indikatorët koherentë; Krijimi i metodologjisë për mbledhjen e të dhënave mbi NSTë; Metoda e Rasteve studimore e aplikuar për studimin rajonal; advokimi për krijimin e fondit rajonal për kërkime mbi NSTë</p>	<p>Organizata Ombrellë OSE Konsorciumi / Rrjeti kërkimor Zyrat kombëtare të statistikave</p>	<p>Sektori privat/ shteti/ BE/ fondet rajonale- Këshilli për Bashkëpunim Rajonal</p>	<p>Numri i projekteve kërkimore Numri i rrjeteve kërkimore Numri i studimeve Numri i indikatorëve Numri i fondeve kërkimore të fituara në dispozicion Shuma e fondeve të kërkimit të fituara në dispozicion</p>	<p>2016</p>



# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

## 4. Promovimi i konceptit të ekonomisë sociale

### 4.1. Si të advokohet dhe llobohet për promovim & zhvillim të ndërmarrjeve sociale në EJK

Qëllimet	Veprimet	Zbatuesi i aktivitetit	Burimet	Mjetet e verifikimit	Grafiku kohor
Krijimi i organizatës ombrellë	Interesa të përbashkët të përcaktuar; Krijimi i çmimeve vlerësuese dhe kompeticioneve; organizimi i fushatave promocionale; fushatat e ngritjes së fondeve; dhënia e çmimit reportazhi më i mirë i historisë së ndërmarrjeve sociale; organizimi i trajnimeve, vizitave studimore dhe sesioneve informative me mediat	Aktorë të interesuar, organizatat advokuese kombëtare dhe Këshilli për Bashkëpunim Rajonal	Financime private/BE/ fonde rajonale- Këshilli për Bashkëpunim Rajonal	Organizata ombrellë e ngritur	2016
Komunikim reciprok dhe konstruktiv me qeverinë				Numri i artikujve, deklaratave për shtyp, Numri i fushatave, eventeve; Numri i çmimeve vlerësuese dhe kompeticioneve	Nga 2016 – në vazhdim
Interes i përbashkët i përcaktuar mes sektorëve				Numri i protokolleve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit të firmosura	Nga 2016 – në vazhdim
Media e përfshirë				Numri i partneriteteve me median; Numri i mediave që marrin pjesë në evente; Numri i raporteve të medias	Nga 2016 – në vazhdim





# BUSINESS FOR THE COMMUNITY WELL-BEING

Social Economy for the Smart,  
Sustainable and Inclusive Growth  
of the South East Europe

## 4.2. Si të komunikojnë ndërmarrjet sociale në EJJ?

Qëllimet	Veprimet	Zbatuesi i aktivitetit	Burimet	Mjetet e verifikimit	Grafiku kohor
<p><b>Kontributi në njohuritë e përgjithshme dhe ndërgjegjësimin mbi NS</b></p> <p>Mes publikut të përgjithshëm në EJJ</p> <p>Mes profesionistëve</p> <p>Emërtim unik i NSve në nivel rajonal</p>	<p>Krijimi i përmbajtjes offline dhe online (për të rinjtë); Dizenjimi dhe hartimi i deklaratave publike-manifesto (për të moshuarit); Hyrja në sistemin e edukimit çka do të nxisë debatin në publik (për të moshuarit); përfshirje e medias; çertifikimi i cilësisë së ndërmarrjeve sociale; Sfida e Rasteve (p.sh Universitetet)</p>	<p>Organizata ombrellë dhe Këshilli për Bashkëpunim Rajonal</p>	<p>Fondet private/ BE/ fonde rajonale- Këshilli për Bashkëpunim Rajonal</p>	<p>Numri i dokumenteve dhe të dhënat mbi NStë; Numri i vizitave në faqet online të NSve; Numri i debateve publike Numri i raporteve mediatike</p> <p>Standartet e çertifikimit të krijuara; Numri i emërtimeve të caktuara</p>	<p>2016 – në vazhdim</p>